



REPUBLIKA E SHQPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

SISTEMI I INTEGRIMIT TË PLANIFIKUAR
PLATFORMA E KOMUNIKIMIT
2010–2013

Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive
dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj



Pasqyra e lëndës

AKRONIMET	3
PËRMBLEDHJE	4
1. HYRJE	5
2. ANALIZË E SITUATËS SË KOMUNIKIMIT TË SPI-së	8
3. UDHËZIME TË PROFILIT TË LARTË PËR KOMUNIKIMIN	12
4. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT	13
5. PUBLIKU I SYNUAR, MESAZHET DHE TEKNIKAT KYÇE	13
6. MJETET PËR ZBATIMIN E UDHËZIMEVE	21
7. PLANI I VEPRIMIT	23
8. BUXHETI PËR KOMUNIKIMIN E SPI-së	28



AKRONIMET

CFCU	Njësia Qendrore Financiare e Kontraktimit
KM	Këshilli i Ministrave
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj
STD	Sekretari Teknik i Donatorëve
DAP	Departamenti i Administratës Publike
NH	Ndihma e Huaj
KMQ	Komiteti për Modernizimin e Qeverisë
QSH	Qeveria e Shqipërisë
GSBI	Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim
IPA	Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
PKSPI	Platforma e Komunikimit të SPI-së
GMSPi	Grupi Mbështetës i SPI-së
ML	Ministritë e Linjës
FSHB	Fondi Shumëpalësh i Besimit
MI	Ministria e Integritimit
PIM	Plani i Integruar i Ministrisë
MF	Ministria e Financave
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
MP	Marrëdhëniet me Publikun
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
KPS	Komiteti i Planifikimit Strategjik
GSP	Grupi Sektorial i Punës
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike



PËRMBLEDHJE

Platforma e Komunikimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (PKSPI) ofron një kuadër udhëzimesh për aktorë të ndryshëm që të punojnë së bashku dhe në mënyrë të harmonizuar, me synimin për të nxitur shkëmbimin e informacionit dhe të njohurive në lidhje me proceset, zbatimin dhe arritjen e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Qëllimi i këtij punimi është që të ofrojë informacionin në mënyrë të strukturuar, në mënyrë që t'ua bëjë të ditur të gjithë aktorëve ecurinë e zbatimit të SPI-së dhe t'i bëjë të kuptojnë se ky është proces i integruar, jo i copëzuar, dhe se është proces i ndërsjellë për dhënien dhe marrjen e informacionit. **Të gjithë, qofshin përfaqësues të një ministrie linje, të një institucioni qendror apo donatorë, janë aktorë që mund të kontribuojnë në suksesin e Platformës së Komunikimit të SPI-së.**

PKSPI strukturon në detaje fluksin e informacionit, mesazhin, publikun të cilit i drejtohet për ecurinë e SPI-së, instrumentet potenciale për përcjelljen e mesazhit, burimet e kërkuara për realizimin, si edhe mekanizmat *feedback* për të mësuar nga ky ushtrim. Ky dokument është bërë kryesisht, por jo vetëm, për qeverisjen qendrore, ministritë e linjës dhe donatorët. Për rrjedhojë, duhet që aktivitetet e komunikimit të jenë të organizuara dhe të marrin pjesë të gjithë aktorët duke përdorur më mirë mjetet dhe kanalet e komunikimit.

Ky dokument përbëhet nga tre seksione kryesore:

- ❖ Përmban **informacion të përgjithshëm për proceset e SPI-së** dhe strukturat e tij institucionale, si dhe hedh një vështrim për komunikimin e SPI-së që kur sistemi u miratua nga Qeveria në vitin 2005.
- ❖ PKSPI synon të informojë qeverinë dhe aktorët për **aktivitetet e shkuara dhe të tanishme të komunikimit që lidhen me SPI-në.**
- ❖ Dokumenti parashikon dhe **planifikon komunikimin e SPI-së për periudhën 2010-2013** që rastis me fazën e re të zbatimit të SPI-së në të gjitha ministritë, duke vënë theksin te siguri i ndihmës teknike, zhvillimi organizativ dhe përmirësimi i kapaciteteve planifikuese dhe buxhetuese nëpër ministri, duke pasur si qëllim arritjen e cilësisë në zbatimin dhe forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të llogaridhënies.

Platforma e Komunikimit të SPI-së përbëhet nga tetë kapituj që përshkruajnë objektivat e komunikimit, publikun të cilit i drejtohet, mjetet dhe aktivitetet e zbatimit të PKSPI-së dhe kanalet e komunikimit për përcjelljen e mesazhit.



1. HYRJE

Në nëntor 2005, Qeveria e Shqipërisë (QSH) miratoi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), një kornizë parimesh operuese në mënyrë që politika planifikuese dhe monitoruese e qeverisë si e tërë të jetë sa më e efektshme dhe e harmonizuar. SPI është sistemi vendimmarrës kombëtar kryesor për të përcaktuar drejtimin strategjik dhe akordimin e burimeve.

Proceset themelore që prekin organizatat qeveritare dhe aktivitetet janë:

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)**, që përcakton objektivat afatmesme dhe afatgjata të qeverisë për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar.
- **Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)**, që i kërkon çdo ministrie të hartojë një plan 3-vjeçar, ku të përcaktojnë rezultatet e programit për arritjen e objektivave dhe qëllimeve brenda tavanit të shpenzimeve, siç përcaktohet në planin fiskal të qeverisë; në procedurat e PBA-së janë përfshirë dhe integruar procedura të reja për investimet publike.
- **Integrimi evropian** shtrihet në procese që përfshijnë zbatimin e MSA-së, IPA-n dhe procesin e përkthimit të *acquis communautaire*. Kërkesat e integritit evropian pasqyrohen në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale që përkthehen në *output*-e nëpërmjet proceseve të PBA-së nën ombrellën e SPI-së.
- **Ndihma e huaj** kërkon që vendimet të merren në nivel strategjik nëpërmjet kuadrit SPI, në varësi të llojeve dhe peshës së ndihmës së huaj që nevojitet. Në bashkëpunim me donatorët dhe ministritë e linjës (ML), Departamenti i Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) ngriti 10 Grupe Sektoriale Pune (dhe 30 nëngrupe) me detyrën që të mundësojnë që ndihma e huaj të koordinohet me efikasitet dhe të mbështesë prioritetet strategjike sektoriale.

Strukturat institucionale të SPI-së

Objektivat e politikave të programit 4-vjeçar të qeverisë janë të harmonizuara me prioritetet sektoriale dhe të SKZHI-së. SPI drejtohet nga disa struktura institucionale:

- ❖ **Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS)** është komiteti ndërministror i kryesuar nga Kryeministri që shqyrton dhe miraton politikat e qeverisë dhe prioritetet fiskale. Që nga krijimi deri në vjeshtën e 2009-ës, janë mbajtur 30 mbledhje të KPS-së, çka dëshmon për angazhimin e QSH-së në zbatimin e SPI-së.
- ❖ **Komiteti i Modernizimit të Qeverisë (KMQ)** është komiteti ndërministror i kryesuar nga Ministri i Shtetit. KMQ miraton metodologjitë e SPI-së dhe garanton që elementet teknike të SPI-së të realizojnë prioritetet qeveritare në mënyrë efektive dhe të efektshme.
- ❖ Aspekti kyç për zbatimin e suksesshëm të SPI-së, është prania e një ekipi të përbashkët menaxhimi në çdo ministri që merret me planifikimin dhe buxhetimin. Për të drejtuar procesin, në maj 2006 në çdo ministri u ngrit një **Grup për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI)**. GSBI menaxhon, garanton cilësinë dhe monitoron zbatimin e SPI-së në ministrinë përkatëse. Grupi kryesohet nga Ministri dhe përfshin zv/ministrat, sekretarin e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e Ekipëve të Menaxhimit të Programit.
- ❖ Në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë me donatorët, QSH krijoi në nëntor 2005 **Grupin Mbështetës të SPI-së** që është organ këshillimor për politikën, apo një forum bashkëpunimi midis qeverisë dhe donatorëve për sa i përket procesit të SPI-së. Gjithsej janë mbajtur 9 mbledhje, ku është raportuar për lëvrimet nga Fondi Shumëpalësh i Besimit si dhe për ecurinë e komponentëve.
- ❖ Gjithashtu me Urdhër të Kryeministrit Nr. 5, datë 30.01.2006 u krijua **Grupi i Koordinimit të SPI-së** i kryesuar nga Zëvendëskryeministri. Kjo strukturë përbëhet nga Zv/ministrat dhe Sekretarët e Përgjithshëm të MI dhe MF dhe Drejtori i DEBASKON-it. **Grupi i Koordinimit të SPI-së** diskuton në nivel teknik çështjet dhe materialet që nevojiten për mbledhjet e KPS-së. Kjo strukturë tashmë drejtohet nga Ministri i Shtetit.



- ❖ **DEBASKONI** u krijua në dhjetor 2005 pranë Këshillit të Ministrave që të ndihmojë në mënyrë që koordinimi i politikave në nivel strategjik të realizohet brenda kuadrit të SPI-së, duke rritur kështu efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien. Për të zbatuar SPI-në, DEBASKON-i ishte motori kryesor në modifikimin teknik dhe harmonizimin e proceseve kryesore. Me rolin e vet qendror në zbatimin e SPI-së, DEBASKON-i është mandatar që prioritetet e Qeverisë dhe kërkesat e Integritit Evropian të pasqyrohen plotësisht në të gjitha politikat kyçe të qeverisë dhe në proceset e planifikimit financiar dhe që t'i komunikohen të gjithë aktorëve. Gjithashtu, DEBASKON-i përgatit dhe ndihmon punimet e KPS-së dhe KMQ-së sipas kalendarit vjetor të SPI-së. DEBASKON-i drejtoi përgatitjet për SKZHI 2007-2013, duke mundësuar konsultime të gjëra me përfshirjen e aktorëve kyçë nga qeveria, sektori privat, shoqëria civile dhe donatorët. Gjatë përgatitjes së SKZHI-së, DEBASKON-i koordinoi procesin e formulimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale nga ana e ministrive të linjës, që shërbeu si *input*-i kryesor për SKZHI-në. Futja e sistemit të monitorimit për zbatimin e SKZHI-së, strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, është një sfidë e re për DEBASKON-in. Ky mjet i ri monitorues do të plotësojë raportin e progresit vjetor të SKZHI-së, që raporton rezultatet vjetore të arritura të matura me një sërë indikatorësh të nivelit të lartë. DEBASKON-i drejton dhe orienton ministrinë e linjës në hartimin e Planeve të Integritit të Ministrisë (PIM) dhe programet vjetore të Ministrisë në kuadrin e SPI-së. Njësia e Koordinimit të Ndhmës së Huaj shërben si një strukturë *one-stop-shop* për donatorët për çështjet strategjike që lidhen me ndihmën e huaj. Si e tillë, kjo njësi është përgjegjësi për organizimin e aktiviteteve madhore koordinuese si tryezat e rumbullakëta qeveri-donatorë dhe Grupin Mbështetës së SPI-së. DEBASKON-i, në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik të Donatorëve, ka krijuar tashmë një bankë të dhënash për donatorët, e cila përmban të dhëna për të gjithë aktorët aktive që kanë punuar në Shqipëri që në 1994, si edhe informacion për fondet e angazhuara dhe të lëvruara. DEBASKON-i bashkëpunon ngushtësisht me Ministrinë e Financave (MF) dhe me Ministrinë e Integritit (MI) për një sërë çështjesh që lidhen me SPI-në. DEBASKON-i dhe këto dy ministri janë aktorët kryesorë në zbatimin e suksesshëm të SPI-së.
- ❖ **MIE** dhe DEBASKON-i punojnë bashkë për të garantuar që prioritetet e Integritit Evropian të jenë pjesë integrale e të gjitha proceseve të qeverisë. MIE drejton procesin e përditësimit dhe monitorimit të PKZMSA-së dhe garanton që zbatimi i MSA-së të pasqyrohet në buxhetin e PBA-së. DEBASKON-i merr pjesë në negociatat e drejtuara nga MIE për programimin e IPA-s. Ministria është Koordinatore Kombëtare e IPA-s (KKIPA), dhe përgjegjësia e saj është në informojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin e aktorëve kryesorë për disponibilitetin e fondeve të BE-së në komponentët IPA, si dhe të ftojë ministrinë e linjës dhe përfituesit e tjerë potencialë që të dorëzojnë projekte. Pastaj, kalendari i programimit të IPA-s dhe lista e projekteve të miratuara publikohet në faqen e internetit të MIE-s. Ministria organizon sesione të shumta me aktorët kryesorë për të prezantuar komponentët e IPA-s, ndërkohë që janë planifikuar edhe broshura dhe fletëpalosje për publikun e gjerë. Pas aplikimit për statusin kandidat, Ministria ka marrë rol drejtues edhe në koordinimin e procesit të përgatitjes së përgjigjeve për PyetëSORIN, si dhe ka përgatitur një plan pune të plotë me afate dhe përgjegjësi për çdo institucion të përfshirë. Komiteti Ndërmintor i Integritit i kryesuar nga Kryeministri u krijua për të adresuar çështjet e integritit, ndërsa MIE ka rol kyç. Gjithashtu, një task-forcë e krijuar brenda Ministrisë po menaxhon fushatën ndërgjegjësuese dhe po zbaton planin e veprimit të informimit të publikut në lidhje me çështjet e BE-së. Më 24 nëntor 2009, u hap në Tiranë një Qendër Informimi për çështjet e BE-së, e financuar nga BE dhe e mbështetur nga MIE, e cila do t'i ofrojë publikut informacion për procesin e Integritit Evropian. Përveç se ofron mundësinë për konsultim të drejtpërdrejtë me personelin e




qendrës, publikime të printuara dhe në format elektronik, akses në internet, si dhe do të ketë një kënd të rehatshëm leximi. Pika informimi për BE-në ekzistojnë në qytete universitare si në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastër dhe Korçë. Ky hap do të rrisë ndërgjegjësimin publik për çështjet e Integritimit Evropian.

- ❖ **MF** përgatit vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike që nevojiten për vendosjen e prioritetëve strategjike, shpenzimeve agregate, dhe objektivave për të ardhurat dhe deficitin. Gjithashtu, MF drejton përgatitjen e taveve të PBA-së në nivel ministrie. MF dhe DEBASKON-i garantojnë që PBA dhe Buxheti Vjetor të pasqyrojnë prioritetet strategjike të Qeverisë, si dhe bashkëdrejton negociatat me donatorët për kushtet e lidhjes së huave me politikën. Me futjen e instrumenteve të reja monitoruese, Ministria e Financave duhet të kryejë Vlerësimin e Impaktit Fiskal duke identifikuar ndikimet shumëvjeçare buxhetore.
- ❖ **Fondi Shumëpalësh i Besimit i SPI-së.** Që të kuptohet dhe të zbatohet më mirë procesi SPI-së, metodologjia dhe produktet e tij në nivelet e qeverisjes u krijua në vitin 2008 (do të lëvrohet deri në 2010) **Fondi Shumëpalësh i Besimit** prej 7,19 milion USD si kontribut i 7 donatorëve¹ dhe i menaxhuar nga Banka Botërore. Ky fond synon të mbështetë zbatimin e komponentëve të ndryshëm të PSI-së, duke u përqendruar në forcimin e kapaciteteve për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive, në menaxhimin e shpenzimeve dhe në koordinimin e ndihmës.

Sekretari i Përgjithshëm shërben si **Koordinator i SPI-së** për Ministrinë dhe si pikë kontakti për DEBASKON-in në KM për çështjet që lidhen me SPI-në. Zbatimi i SPI-së orientohet nga plani i zbatimit të tij.

Diagrama më poshtë shpjegon si funksionon SPI dhe si bashkëpunojnë, koordinohen dhe raportojnë strukturat institucionale. Në çdo ministri, ekipet e menaxhimit të çdo programi raportojnë te GSBI, i kryesuar nga Ministri dhe i përbërë edhe nga Zv/ministri, Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët. DEBASKON-i vepron si sekretarit teknik dhe punon ngushtësisht me MF-në dhe MIE-n për të garantuar që prioritetet të lidhen me buxhetin dhe të pasqyrojnë agjendën e Integritimit Evropian.

1



2. ANALIZË E SITUATËS SË KOMUNIKIMIT TË SPI-së

Deri më sot nuk ka qenë miratuar një strategji komunikimi. Në përgjithësi komunikimi është kufizuar në disa konferenca dhe seminare. Deri tani, informacioni për SPI-në ka qenë i qendëruar dhe lokalizuar në disa kontakte apo aktorë aktivë në grupet sektoriale të punës, pa përfshirë pjesën tjetër të administratës. Si rezultat, ndërjegjësimet për SPI-në është mjaft i lartë mes vendimmarrësve dhe donatorëve, por shumë më i pakët brenda ministrive të linjës zbatuese.

Këto janë dy pyetjet që duhet të adresohen:

1. Çfarë ka arritur SPI deri tani në lidhje me komunikimin?
2. Si të mësojmë nga e shkuara dhe si të shfrytëzojmë mundësitë e ardhshme?

Nëse iu përgjigjemi këtyre pyetjeve dhe identifikojmë disa nisma të ardhshme optimiste, mund të përftojmë disa mundësi shumë të mira për komunikimin.

Mjetet e komunikimit të përdorura përfshijnë:

- ◆ Materialet trajnuese për administratën publike, edhe pse të paktën japin njohuri teorike për kuadrin SPI, ende nuk janë përdorur plotësisht. Në kursin trajnues të ITAP-it, nuk krijohet një ide reale për SPI-në dhe si duhet të perceptohet. Nuk ka shembuj se si proceset lidhen dhe shkojnë bashkë nën këtë ombrellë. Një tjetër problem është mosdiferencimi i kurseve, madje i jepet i njëjti trajnim personelit të DEBASKON-it dhe aktorëve të tjerë SPI-së.
- ◆ Takimet me GSBI në ministrinë e linjës rezultuan të dobishme, por janë kufizuar në pjesëmarrjen vetëm të një numri të vogël profesionistësh, dhe këto takime janë të rralla.
- ◆ Seminaret e organizuara me Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive të Linjës dhe Ministrat për ta vënë SPI-në në nivel strategjik, shihen si të efektshme. Në seminarin e



majit 2007 për ministrat, zv/ministrat dhe sekretarët e përgjithshëm, Kryeministri iu drejtua secilit grup dhe e bëri të qartë që zbatimi i SPI-së duhet të bëhet prioritet personal për çdo Ministër. Zyrtarët e lartë MF-së dhe MIE-s, dhe stafi i DEBASKON-it dhanë prezantime për zbatimin e SPI-së.

- ◆ Deri në tetor 2007, janë transmetuar 10 debate televizive (*Sfida dhe Strategji*) në televizionin publik shqiptar, TVSH. Shtatë debatet e para u regjistruan në qytete të ndryshme dhe secili trajtoi një sektor të veçantë: arsimi (Korçë), zhvillimi rural (Lushnjë), turizmi (Vlorë), kujdesi social (Gjirokastër), infrastruktura (Durrës), shëndetësia (Elbasan) dhe mjedisi (Shkodër). Tre debatet e tjera u regjistruan në Tiranë dhe u përqendruan në prioritetet kryesore strategjike të SKZHI-së – Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës, Zhvillimi Ekonomik dhe Social, dhe Integrimi në BE dhe NATO – dhe u transmetuan më 19 dhe 26 dhjetor 2007. Në këto debate morën pjesë përfaqësues të qeverisë, opozitës, ekspertë teknikë dhe përfaqësues të komunitetit vendor; debatet u financuan nga DFID dhe u mundësuan nga Instituti për Studime Bashkëkohore, dhe ndihmuan në rritjen e ndërgjegjësimit për procesin e SKZHI-së.
- ◆ 3 seminare tematike u organizuan në tetor e nëntor 2007, një për çdo prioritet strategjik: Integrimi në BE dhe në NATO (30 tetor), Zhvillimi Ekonomik dhe Social (6 nëntor) dhe Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës (13 nëntor). Këto seminare u mbështetën nga GTZ dhe morën pjesë grupe të ndryshme interesi. Gjithashtu, u organizuan dy seminare specifike: një për komunitetin e donatorëve (19 nëntor 2007) ku morën pjesë Partnerët për Zhvillim dhe Integrim dhe disa këshilltarë të përzgjedhur nga projekte të ndryshme asistence teknike. Në seminarin tjetër për shoqërinë civile (23 nëntor) morën pjesë përfaqësues nga secili Grup Këshillimor që mbështeti përgatitjen e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, dhe nga përfaqësues të Organizatave Joqeveritare kombëtare. Këto seminare u mbështetën nga DFID. Përveç këtyre, u organizuan edhe 4 seminare në nivel qarku: në Lezhë (9 nëntor), në Pogradec (14 nëntor), në Fier (15 nëntor) dhe në Peshkopi (21 nëntor), ku morën pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, shoqërisë civile vendore, specialistë, studentë dhe akademikë. Në përgjithësi, ky ishte një proces për shkëmbim informacioni që rezultoi në përmirësimin e cilësisë së SKZHI-së dhe rriti ndërgjegjësimin te aktorët vendorë.
- ◆ Tryezat e Rrumbullakëta Qeveri-Donatorë kanë shërbyer si forume të mira për shkëmbimin e informacionit mes donatorëve, qeverisë dhe shoqërisë civile. Për më tepër, evenimentet konsultuese për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të organizuara nga Grupet Këshillimore dhe komuniteti i donatorëve në 2007, u mbuluan nga shtypi i shkruar dhe mediat elektronike. Komunikatat për shtyp të nxjerra në nëntor, mbuluan si procesin e konsultimit për SKZHI-në, ashtu edhe tryezën e rrumbullakët qeveri-donatorë, dhe u publikuan dhe iu shpërndanë medias.



- ◆ Buletini tremujor i DEBASKON-it doli për herë të parë në janar 2007. Buletini u publikua për një vit dhe pati tirazh prej 500 kopjesh në format A4 me ngjyra (në foto, numri i parë i Buletinit, janar-mars 2007).
- ◆ Dialogu me Donatorët u publikua fillimisht në nëntor 2006 në format *MS Word document*, dhe iu ndryshua dizenjoja në nëntor 2007. Që nga numri 23, nëntor 2008, DEBASKON-i dhe STD ranë dakord që të kenë një buletin të përbashkët dhe ia ndryshuan titullin "Dialogu Qeveri-Donatorë". Buletini mujor ka rritur praninë e qeverisë në shkrimet e shumta që mbulojnë



aktivitetet qeveritare, ngjarjet dhe takimet e DEBASKON-it. Duke publikuar përditësimet e SPI-së, buletini ka luajtur rol të rëndësishëm në informimin e donatorëve dhe përfaqësuesve qeveritarë. Buletini dërgohet në rreth 1000 adresa elektronike, si të zyrtarëve të lartë të ministrive të linjës, ministrave dhe zv/ministrave, Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të kabinetit. Me faqen e re të internetit të DEBASKON-it, buletini do të jetë më funksional dhe do të tërheqë më tepër abonentë. Abonimi është i mundur në adresën www.dsd.gov.al, dhe në këtë mënyrë rritet popullariteti i publikimit dhe arrihet shpërndarje më e gjerë. Ky dokument ndihmon në rritjen e numrit të vizitorëve të kësaj faqe interneti. Buletin gjendet vetëm në anglisht (në foto, botimi i prillit 2009).



- ◆ Edhe materialet e shtypura kanë luajtur rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit për SPI-në, siç janë:
 - ✦ **SKZHI 2007–2013** është dokumenti thelbësor strategjik i Shqipërisë. Për herë të parë, harmonizohet perspektiva e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social me integrimin në Bashkimin Evropian. SKZHI u finalizua në dhjetor 2007 dhe i miratua me VKM në mars 2008.
 - ✦ **Raporti i Progresit të SKZHI-së** është botim i përvitshëm i DEBASKON-it. Ky është një komponent i rëndësishëm i sistemit monitorues dhe përmbledh progresin dhe performancën në të gjithë sektorët. Raporti shpërndahet gjerësisht në qeverisje, në nivel qendror e vendor dhe te institucionet kryesore. Raporti i Progresit 2005 u publikua në shtator 2006, ndërsa Raporti i Progresit 2006-2007 u publikua në dhjetor 2008.
 - ✦ **Kalendari i SPI-së** nxirret në fillim të çdo viti dhe përmban të gjitha aktivitetet e zbatimit të SPI-së, si edhe aktivitetet e donatorëve në Shqipëri. Kalendari është kontribut i përbashkët i DEBASKON-it, MF-së dhe MIE-s dhe u shpërndahet të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e SPI-së, përfshi qeverinë dhe donatorët. Kalendari përmban informacion shpjegues për procesin e SPI-së, progresin e arritur në çdo komponent dhe jep agjendën e plotë të aktiviteteve për vitin pasardhës.
 - ✦ **Programi i Buxhetit Afatmesëm** i publikuar nga MF informon në lidhje me buxhetin e akorduar për një periudhë 3-vjeçare, duke bërë një lidhje të qartë mes buxhetit dhe objektivave të programit. Janë planifikuar përmirësime në numrin e radhës, për sa i përket përmbajtjes dhe dizenjës, që të jetë më i lehtë për t'u lexuar.
 - ✦ **Raporti i Progresit të Stabilizim-Asociimit** i përgatitur çdo vit, përshkruan marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në; analizon situatën në Shqipëri në lidhje me kriteret ekonomike dhe politike të anëtarësimit; dhe shqyrton kapacitetet e Shqipërisë për zbatimin e standardeve evropiane, domethënë për përafrimin gradual të legjisllacionit dhe politikave të brendshme me *acquis*, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe me prioritetet e Partneritetit Evropian.
 - ✦ **Planet e Integuara të Ministrisë (PIM)** janë dokumente vjetore që përcaktojnë angazhimet kryesore të PBA-së. Planet përgatiten nga ministritë e linjës, me ndihmën e DEBASKON-it, MF-së dhe MEI-s dhe përmban dy pjesë kryesore: **Raportin Vjetor të Ministrisë** ku evidentohen rezultatet e arritura në raport me angazhimet e PIM-it të vitit paraardhës, dhe **Planin e Monitorimit të Ministrisë** që përmban një sërë objektivash dhe kërkesash ligjore kryesore, të rëna dakord me ML, për monitorimin dhe raportimin.



- ✦ **Dokumenti i Orientimit të Ndhmës së Huaj (DONH)** u përgatit për herë të parë në prill 2008. Ky dokument orientimi ofron këndvështrimin e qeverisë për rolin e ndihmës së huaj në zhvillimin e Shqipërisë, dhe përparësitë e ndihmës së huaj në të ardhmen, për periudhën 2008-2013 bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). DONH jep udhëzime si për projekte të menjëhershme edhe për programimin afatmesëm për periudhën 2008-2013. Dokumenti identifikon edhe mënyrat përmes të cilave qeveria do të rrisë nivelin e zotërimit në menaxhimin e ndihmës së huaj.

2.1 Publikime dhe përditësime gjatë vitit 2009

- ✦ **Raporti i Programit 2008 i Ndhmës së Huaj** u publikua për herë të parë në tetor 2009 dhe paraqet një këndvështrim analitik të aktivitetit donator në Shqipëri si dhe mbështetjen e tyre për çdo sektor që nga viti 2000.
- ✦ **Progresi i Raportit 2008 i SKZHI-së** u finalizua dhe do të publikohet në dhjetor 2009. Progres Raportet për Ndhmën e Huaj dhe për SKZHI-në do të vazhdojnë të jenë dokumentet më të rëndësishme dhe më angazhuese të përgatitur nga DEBASKON-i dhe partnerët e tij. Aktualisht po shihet mundësia për shkrirjen e këtyre dokumenteve në një të vetëm pasi kjo mundëson krahasimin.
- ✦ **Komponentët e SPI-së**
Këto pesë komponentë u publikuan nga DEBASKON-i si një dosje SPI dhe iu shpërndanë rreth 250 pjesëmarrësve në Konferencën e Koordinimit të Donatorëve. Ato janë dokumente njëfaqësh që mbulojnë Integrimin Evropian, SKZH-në, Ndhmën e Huaj, Programin Buxhetor Afatmesëm dhe Monitorimin. Secila fletushkë përmban informacion të sintetizuar për komponentët e SPI-së, si dhe jep përkufizimin dhe ecurinë e secilit komponent.



- ✦ **Manuali i SPI-së**
Fillimisht u ideua për ministrat, pastaj materiali i përditësua, u përshtat dhe u bë manual për përdoruesit e gjerë, duke synuar kështu një publik më të madh.
- ✦ **Kalendari i SPI-së** i nënshtrohet përditësimit të përvitshëm. Doli në fillim të vitit 2009 dhe iu shpërnda në format elektronik të gjithë aktorëve.
- ✦ **Broshura e DEBASKON-it**
Broshura e parë për Departamentin, e përgatitur dhe e publikuar në mars 2009, jep një panoramë të DEBASKON-it dhe rolit të tij në zbatimin e SPI-së. Broshura përshkruan të gjitha aktivitetet e realizuara nga Departamenti si pjesë e punës së tij në proceset e SPI-së, si edhe biografi të shkurtra të ekipit të DEBASKON-it. Ajo u shpërnda gjerësisht dhe u prezantua në Konferencën e Koordinimit të Donatorëve në prill 2009. Broshura është e rëndësishme për kuadrin e SPI-së, pasi informon aktorët e rinj reth pozicionit dhe rolit të DEBASKON-it, duke rritur imazhin e vet të qeveria, donatorët dhe partnerët.



- ✦ **Kalendari i GSP-ve** me datat e takimeve të GSP-ve, u botua për herë të parë në janar 2009 dhe iu prezantua komunitetit donator. Sipas këtij kalendari, GSP-të duhet të mbledhen të paktën një herë në tre muaj. Kalendari i nënshtrohet përditësimit të përvitshëm.
- ✦ **Faqja e internetit.** Faqja e internetit e DEBASKON-it i financuar nga Fondi Shumëpalësh i Besimit, u bë funksionale në mars 2009. Faqja e internetit u përgatit para konferencës rajonale për Koordinimin e Donatorëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi që u zhvillua në 2-3 prill 2009. Qëllimi ishte që të nxitet përhapja e informacionit që lidhet me konferencën dhe të promovoheshin marrëdhëniet ndërmjet QSH-së dhe donatorëve, që së bashku kanë zhvilluar një arkitekturë mjaft efektive për dialogun e politikave, shkëmbimin e informacionit dhe SPI-në. Faqja e internetit përmban informacion të hollësishëm për DEBASKON-in, proceset e SPI-së, produktet, një gamë publikimesh (SKZHI, Raportet e Progresit të SKZHI-së dhe Ndihmës së Huaj), informacione për donatorët, si edhe një bazë të dhënash dhe lidhje për faqet e internetit të donatorëve. Faqja e internetit do të shërbejë edhe si një portë informimi për procesin dhe progresin e SPI-së. Mund të hapet me adresën www.dsd.gov.al ose nëpërmjet linkut të DEBASKON-it në faqen e Këshillit të Ministrave apo të faqes së Sekretariatit Teknik të Donatorëve.

3. NJË PLATFORMË KOMUNIKIMI E PROFILIT TË LARTË

Nëse kihet parasysh përmirësimet e shumta në sistemin e planifikimit dhe dimensionet e gjera të arritjeve të pritshme, nevoja për një platformë të profilit të lartë për komunikimin është e madhe. Në fakt, organizimi i të gjitha aktiviteteve të planifikuara për një publik caktuar, kërkon rritje të ndjeshme të profilit krahasuar me përpjekjet e mëparshme.

Viti 2010 është viti i pestë i zbatimit të SPI-së. Gjithashtu, është viti kur do të finalizohen të gjitha metodologjitë bazë. Qeveria po eksploron mënyrat për të shtuar përfshirjen e shoqërisë civile dhe të grupeve këshillimore në monitorimin e strategjive. Nëse ndërmerret një ushtrim i madh për rishikimin e strategjive dhe për t'i dhënë rol kuptimplotë shoqërisë civile, kjo do të ishte një mundësi për të komunikuar jo vetëm një qasje transparente dhe përfshirëse, por edhe arritjet e ndjeshme të vetë strategjive sektoriale.

Pas dorëzimit më 28 prill të aplikimit për anëtarësim në BE, QSH do të përfshihet në përgatitjen e një Kuadri Strategjik Koherent, që është dokumenti strategjik që i mundëson qeverisë aksesin në më shumë fonde IPA. Kjo fazë e re do ta pozicionojnë DEBASKON-in si një aktor të vazhdueshëm dhe do të mundësojë ri-konceptimin e rolit të SPI-së në raport me Integrimin Evropian. Futja e instrumenteve të politikave, si psh vlerësimet e impaktit, ofron një tjetër mundësi të mirë për të komunikuar përpjekjet e vazhdueshme për zbatimin e suksesshëm.

Ka dy arsye pse duhet të ndiqet një komunikim agresiv për SPI-në, si plan afatshkurtër, ashtu edhe në planin afatgjatë:

- Afatshkurtër: Qeveria i kushton rëndësi të madhe SPI-së dhe rolit që do të luajnë ministratë. Për Zv/ministrat dhe Sekretarët e Përgjithshëm që janë ende në detyrë, është e rëndësishme të theksohet se KPS vazhdon të mbështesë procesin e SPI-së. Për Zv/ministrat dhe Sekretarët e Përgjithshëm të rinj në detyrë, është vendimtare që të dinë nivelin e mbështetjes politike që SPI gëzon. Për më tepër, me zhvendosjen e vëmendjes nga modelimi i sistemit tek zbatimi i tij nëpër ministri, duhet të theksohet fakti që Ministrat dhe drejtuesit e lartë ministrorë marrin kështu një përgjegjësi shumë më të madhe.



- Afatmesëm: Raundi i përmirësimeve të radhës, që do të zbatohet në dy vitet e ardhshme, do të finalizojë metodologjinë e SPI-së. Me fillimin e zbatimit, SPI duhet të reklamohet si në radhët e administratës publike ashtu edhe ndërkombëtarisht si një histori suksesi "Made in Albania".

4. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

PKSPI 2010–2013 synon të rrisin ndërgjegjësimin dhe t'i japin publikut të synuar informacion praktik dhe të sintetizuar për çështjet e SPI-së, si edhe të rrisë rolin e DEBASKON-it si lehtësues, përshpejtues dhe pikë lidhëse mes qeverisë dhe donatorëve. Objektivat e përgjithshme të udhëzimeve të komunikimit janë si vijon:

1. Lehtësimi i komunikimit brenda institucioneve të QSH-së dhe nxitja e kanaleve ekzistuese të komunikimit, për përcjelljen e informacionit te segmentet e ndryshme të publikut, duke nxitur bashkëpunim më të mirë mes partnerëve dhe duke krijuar sinergji, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja në aktivitetet që lidhen me SPI-në.
2. Informimi i përditësuar për zbatimin e SPI-së, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të rregullta të komunikimit, përditësimit të faqeve të internetit dhe përgatitjes së materialeve informative të shtypura dhe elektronike.
3. Përmirësimi dhe krijimi i mekanizmave të rinj për përhapjen e informacionit për aktivitetet që lidhen me SPI-në brenda strukturave qeveritare, pasi publiku kryesor që synohet janë institucionet e QSH-së.
4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe e botëkuptimit për proceset e SPI-së, lehtësimi i mundësive për debat publik dhe shkëmbim njohurish, si dhe përcimi i informacionit nga aktorët joqeveritare tek vendimmarrësit që të informohen për planifikimin në të gjitha nivelet.
5. Përmirësimi i komunikimit për aktivitetet e SPI-së që të kuptohet e aksesohet lehtësisht nga partnerët dhe media, duke nxitur zbatimin efektiv dhe cilësor të SPI-së.
6. Rritja e nivelit të njohurive për SPI-në në radhët e nëpunësve civile dhe personelit të ministrive të linjës, me të paktën 30% në vitin e parë të zbatimit të PKSPI. Para dhe pas trajnimeve mund të bëhen testime për të matur arritjen e këtij objekti.

5. PUBLIKU I SYNUAR, MESAZHET DHE TEKNIKAT KYÇE

Kjo platformë komunikimi synon tre grupe publiku: parësor, dytësor dhe influencues. Dhënia e mesazhit të duhur te publiku parësor ka impakt në suksesin e përgjithshëm, pasi ata vetë janë aktorë. Publiku dytësor është gjithashtu i rëndësishëm, pasi mund të përfshihet drejtpërdrejt ose të përfitojnë nga proceset e SPI-së, ndërsa grupi i tretë përbëhet nga njerëzit që kanë autoritet për të ndikuar në mënyrën e të menduarit dhe të interpretuarit të rezultateve. Është bërë ky grupim për ta pasur më të lehtë strukturimin e informacionit dhe kanaleve që do të përdoren, por nuk është një ndarje si me thikë, pasi influencë mund të kenë edhe individët e publikut parësor.



Grupi parësor	Grupi dytësor	Grupi influencues
Ministrat, Zv/Ministrat Sekretarët e Përgjithshëm Drejtorët e politikave dhe financave të Ministrisë (GSBI) Donatorët Nëpunësit civilë Shoqëria civile	Pushteti vendor Komuniteti Ndërkombëtar Media Pushteti Rajonal Qeveria Parlamenti Publiku i gjerë (ku përfshihen komunitetet përfituese dhe grupet sociale apo ekonomike)	Kryeministri Ministri i Shtetit DEBASKON, MF, MIE, Të tjera Aktorët kryesorë Media

Për zhvillimin e PKSPI-së, duhet të konsultohen një sërë aktorësh kryesorë në lidhje me nismat e komunikimit të ideuara enkas për rolin e tyre në SPI. Prandaj kërkohet përshkrim i secilit grup, publiku dhe qasja e këtij dokumenti për të komunikuar mesazhin e duhur, që i gjeni të detajuara më poshtë:

Mesazhet dhe teknikat kyçe të komunikimit

5.1 Ministrat, Zv/ministrat

- **Ministrat: vendimmarrje kolektive si anëtar i KM-së;** përgjegjës për strategjitë e ministrive
- **Zv/ministrat: rol kyç në formulimin e strategjive dhe kryetarë të GSP-ve**

Për Ministrat dhe Zv/ministrat, nevojitet vetëm një eveniment me impakt të lartë.

Seminari i vitit 2007 për Ministrat, Zv/Ministrat dhe Sekretarët e Përgjithshëm, i injektoi energji procesit të SPI-së dhe dërgoi sinjalet e duhura që çështjet teknike si strategjitë dhe buxheti mbartin pasojë të madhe politike dhe kërkojnë përfshirje personale dhe konstante të Ministrave dhe drejtuesve të lartë. Një eveniment i ngjashëm duhet të organizohet edhe në fillim të 2010-ës, pas miratimit të kuadrit makro, prioritetëve të politikave dhe tavaneve të ministrive. Për më tepër, për të përforcuar rëndësinë e SPI-së, ky eveniment mund t'i ofrojë Kryeministrit mundësinë që diskutojë prioritetet imediate dhe afatmesme të Qeverisë.

MESAZHET KYÇE:

Tani vëmendja duhet të kalojë nga projektimi dhe planifikimi, tek zbatimi. Qeveria pret që ministrinë të jenë vigjilente për të garantuar që planet e tyre të përkthehen në përmirësime konkrete në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare;

Shqipëria po hyn në një fazë vendimtare të përpjekjeve për anëtarësim në BE. Çdo ministri duhet të sigurohet që planet dhe buxhetet e saj të mbështesin plotësisht zbatimin e angazhimeve të saj për integrimin evropian.

Teknika: Mesazhet kyçe mbeten të vlefshme përgjatë të gjithë vitit të parë dhe do të vazhdojnë të jepen edhe pas ngritjes së strukturave të SPI-së. Është e rëndësishme që zyrtarët e lartë politikë dhe administrativë të dëgjojnë drejtpërdrejt Kryeministrin në mbledhjet e KPS-së, ndërsa mesazhet e Ministrisë të Shtetit që kryeson Grupin e Koordinimit të SPI-së, të Ministrisë të Financave dhe të Ministrisë të Integritimit, mund të përforcojnë mesazhet e Kryeministrit.

5.2 Sekretarët e Përgjithshëm

- *rol kyç në zbatimin e SPI-së*
- *përgjegjës për sigurimin e cilësisë dhe koordinimin*



- *takime periodike të të gjithë Sekretarëve të Përgjithshëm që mbledhen nga Sekretari i Përgjithshëm i KM-së shërben si forum i mirë për shkëmbim informacioni*

Sekretari i Përgjithshëm i KM-së kryeson një forum periodik me të gjithë Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive. Kjo strukturë u përdor disa herë për të përcjellë informacion për çështje të SPI-së. Ndërkohë që zbatimimi vazhdon dhe procese të reja (p.sh. vlerësimi i impaktit) futen në proces, roli i Sekretarëve të Përgjithshëm do të bëhet edhe më i rëndësishëm.

Sekretarët e Përgjithshëm janë urë lidhëse mes niveleve politike dhe administrative dhe sigurojnë që administrata e mesme dhe nëpunësit civilë të kuptojnë SPI-në dhe përgjegjësitë/rolet respektive. Për këtë qëllim, Sekretarët e Përgjithshëm duhet të kuptojnë SPI-në në nivel të gjerë teknik. Gjithashtu, për këtë grup duhet të funksionojë forumi i tyre periodik ku të ndajnë praktikën më të mira, të bëjnë pyetje dhe t'i japin *komente* institucioneve qendrore.

Me 13 tetor 2009 u organizua një tryezë e rrumbullakët e kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KM-së dhe Drejtori i DEBASKON-it, ku merrnin pjesë ministrinë e linjës, Sekretarët e Përgjithshëm, stafi i DEBASKON-it dhe konsulentë ndërkombëtarë të SPI-së. Qëllimi ishte që të informoheshin për SPI-në dhe ecurinë e këtij procesi, duke eksploruar praktikën më të mira dhe duke evidentuar mjetet produktive që mund të rrisin kapacitetet operative dhe planifikuese të ministrive. Ky takim pati pjesëmarrje të lartë dhe realizoi me sukses objektivat.

MESAZHET KYÇE:

Me kalimin e SPI-së nga projekti në zbatim, rritet edhe rëndësia e rolit të Sekretarit të Përgjithshëm;

SPI dhe proceset bazë (PBA, SKZHI, Integrimi Evropian dhe ndihma e huaj) do të vihen në agjendën e çdo mbledhjeje periodike të forumit të Sekretarëve të Përgjithshëm;

Sekretari i Përgjithshëm i KM-së përcjell informacion dhe siguron *feedback* se çfarë po funksionon mirë dhe çfarë jo.

Teknika: Për të adresuar këto nevoja, duhet të mbahen parasysh këto masa:

- një mbledhje gjysmëditore e organizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave në fillim të vitit 2010
- të vazhdohet praktika e mbledhjeve të përbashkëta me të gjithë Sekretarët e Përgjithshëm duke pasur SPI-në si pikë të përhershme të agjendës; këto mund të sinkronizohen me kalendarin e takimeve të GSBI-së; dhe
- DEBASKON-i të bashkëpunojë më ngushtë me Departamentin Ligjor të KM-së në përgatitjen e Planit Vjetor Ligjor; DEBASKON-i duhet të prezantojë vlerësimet e impaktit dhe duhet të mbështesë më mirë Sekretarin e Përgjithshëm të KM-së me mbledhjet e Sekretarëve të Përgjithshëm dhe me mbledhjet e KPS-së.

5.3 Grupi i Administratës së Lartë të Ministrisë (GSBI)

- *vendimmarrës brenda ministrive*

GSBI përbëhet kryesisht nga Ministra, Zv/ministra, Sekretarë të Përgjithshëm Profesionalistë të Politikave/Buxhetit, prandaj Platforma e Komunikimit do të përqendrohen te ata individualisht:

MESAZHET KYÇE:

Rëndësia e GSBI-së të çdo ministrie rritet ndjeshëm kur SPI kalon në zbatim nëpërmjet ministrive të linjës;

Në 2010, prioritetet qeveritare të SPI-së duhet të kenë të përfshirë vlerësimet e performancës, monitorimit dhe impaktit;

Deri në fund të 2010, do të finalizohen të gjitha metodologjitë e SPI-së; në vitet e ardhshme, fokusi do të jetë në përmirësimin e rezultateve.

Teknika: Në fillim të çdo viti, DEBASKON-i duhet t'i përcjellë çdo ministrie Kalendarin e Planifikimit të Integruar që miratohet nga KPS dhe që përmban datat e mbledhjeve të KPS-së si



dhe afatet e proceseve kryesore. Në kalendarin 2010, duhet të përfshihet një përditësim i SPI-së, me qëllim që t'iu kujtohet GSBI-ve roli i tyre qendror dhe të vihen në dijeni për përmirësimet e reja në procesin e SPI-së. Parashikohet që ministritë të marrin asistencë teknike nëpërmjet Fondit të Besimit për të mbështetur forcimin e kapaciteteve. Duhet të ekzistojë raportim periodik dhe përditësimet për SPI-në t'iu dërgohen të gjithëve me e-mail.

5.4 Zyrtarët e Politikave/Buxhetit

- *mbikëqyrin drejtpërdrejt shumicën e punës*
- *janë ndër burimet më të mira për evidentimin e problemeve dhe përmirësimeve të nevojshme në proces*

Këta janë një grup publiku vendimtar pasi kryejnë pjesën më të madhe të punës teknike. Ata janë përgjithësisht të vetëdijshëm për SPI-në, por përqendrohen te detyrat individuale për të cilat janë përgjegjës, domethënë përgatitjen e projekt-PBA-së të ministrisë, koordinimin e strategjisë sektoriale të ministrisë, koordinimin e angazhimeve të Integritit Evropian, raportimin për rezultatet, etj.

Teknika: Për këtë grup duhet të organizohen trajnime të specializuara dhe sesione informimi. Mundësia për të ideuar kurse kualifikimi standarde për planifikimin strategjik dhe buxhetimin e performancës, duhet të diskutohen me ITAP-in dhe DAP-in. Duhet të shqyrtohet edhe mundësia që në fillim të çdo cikli planifikimi të organizohet një seancë informuese vjetore për të gjithë profesionistët e politikave/buxhetit dhe me koordinatorët e BE-së, me qëllim prezantimin e përmirësimeve në proces dhe shkëmbimin e praktikave më të mira për vitin në vijim. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për formimin e rrjeteve.

5.5 Shërbimi Civil

- *kërkohet ndërgjegjësim i përgjithshëm pasi ministritë fillojnë zbatimin aktiv të SPI-së*
- *SPI duhet të jetë modul në trajnimet e ITAP-it*

Nëpunësi di shumë pak për të mos thënë asgjë për SPI-në. Nisur nga qendërzimi i SPI-së, mënyrat se si merren vendimet financiare dhe për politikat dhe si mbështetet Integriti Evropian, është e nevojshme që të kihet një nivel i përgjithshëm njohurish.

Edhe pse cilësia dhe detajet teknike të sistemeve qeveritare të planifikimit, siç është SPI, kanë fare pak lidhje apo interes për shumicën e nëpunësve civil apo publikun e gjerë, mesazhi që Qeveria e Shqipërisë po menaxhon burimet e saj me efektivitet dhe efikasitet dhe që përpiqet të përmirësojë jetën e përditshme të shqiptarëve, bën rezonancë vetëm nëse dëshmohet me prova solide. Një pikënisje mund të jetë dokumentimi i sukseseve të ministrive ku qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë dhe planet e kësaj ministrie janë arritur dhe kanë gjeneruar përmirësime ekonomike dhe sociale që kanë ndikim pozitiv në cilësinë e jetës së shqiptarëve. Nuk është e domosdoshme që SPI të jetë në qendër të këtyre historive suksesi, por duhet gjithmonë të përmendet. Për donatorët, ky do të ishte një sinjal që investimet e tyre për SPI-në po japin fryte në praktikë. Dhe te nëpunësit civilë shqiptarë, do të përcillet mesazhi që politikat dhe planifikimi i shëndoshë financiar prodhojnë rezultate të prekshme për qytetarët.

Teknika: Trajnime ndërgjegjësuere për shërbimin civil janë të rëndësishme. Më konkretisht, ITAP mund të përfshijë një modul për SPI-në në kurset bazë për administratën publike (në kursin e detyrueshëm për nëpunësit civilë). Një kurs dyditor për SPI-në brenda programit trajnues për shërbimin civil, do të ishte i përshtatshëm. Përveç kësaj, duhen gjetur mekanizma që tërheqin nëpunësit civilë të hapin faqen e internetit të DEBASKON-it.

5.6 Donatorët

Përmirësimet e propozuara ofrojnë mundësinë e rifreskimit të komunikimit me donatorët në disa nivele.



- donatorët bëhen të vetëdijshëm për këtë raund përmirësimesh, që metodologjia e SPI-së është e plotë dhe që rëndësia zhvendoset te zbatimi dhe forcimi i kapaciteteve në ministritë e linjës; dhe
- me rigjallërimin dhe zgjerimin e Grupeve Sektoriale të Punës, donatorët do të kenë mundësinë të monitorojnë rezultatet e arritura, të japin këshilla për politikën, dhe të harmonizojnë më mirë ndihmën e huaj me prioritetet.

Donatorët që punojnë në Tiranë janë njohur gjerësisht me SPI-në. Disa nga forumet kryesore për ndërveprimin e tyre me qeverinë në lidhje me SPI-në janë:

Sekretariati Teknik i Donatorëve (STD): Edhe pse ky grup është specifikisht për donatorët, DEBASKON-i ftohet shpesh në këto mbledhje. STD shërben si kontakt i vazhdueshëm i drejtpërdrejt me DEBASKON-in.

Grupi Mbështetës i SPI-së: Kjo strukturë e përbashkët qeveri-donatorë, që mbledhet kryesisht për çështje të Fondit të Besimit, do të bëhet më aktive me rritjen e lëvimeve nga fundi i vitit 2010. Rekomandohet që shtrirja e Grupit Mbështetës të zgjerohet, duke përfshirë koordinimin e komunikimeve me jashtë si edhe sigurimin e orientimit teknik.

Grupet Sektoriale të Punës: GSP-të do të vazhdojnë të luajnë rol kyç si forume për shkëmbim informacioni mes qeverisë dhe donatorëve, prandaj duhet të shikohet mundësia që GSP-të të përdoren më mirë. Këto grupe do të mbledhen sipas kalendarit të GSP-ve në fillim të çdo viti. Shpeshësia dhe datat e mbledhjeve përcaktohen rast pas rasti nga anëtarët e secilit GSP. GSP-të i shërbejnë si qeverisë ashtu edhe donatorëve për të identifikuar fushat për probleme dhe programe të përbashkëta, si edhe për të analizuar nevojat për zhvillim kapacitetesh. Qëllimi kryesor është që grupe të tilla të ngrihen për çdo sektor ku ekziston një strategji sektoriale apo ndërsektoriale.

Tryezat e Rrumbullakëta Qeveri-Donatorë: këto evenimente të rëndësishme organizohen bashkërisht nga DEBASKON-i dhe STD-i dhe marrin pjesë përfaqësues të donatorëve dhe të qeverisë. Këto tryeza mbahen një herë në vit (por janë mbajtur edhe tryeza të jashtëzakonshme). E fundit u mbajt në nëntor 2009, ku pjesëmarrja ishte e lartë dhe i realizoi objektivat. Tryezat e rrumbullakëta cilësohen si forumi më i madh i qeverisë dhe komunitetit donator për trajtimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e SPI-së dhe efikasitetin e ndihmës së huaj. Këto evenimente janë mundësi e mirë për promovimin e SPI-së dhe të DEBASKON-it te publiku dhe media. Shpesh janë prezantuar përditësimet në SPI dhe janë përgatitur komunikata për shtyp me këtë rast.

MESAZHET KYÇE:

Qeveria e Shqipërisë dhe donatorët kanë zhvilluar bashkërisht një strukturim mjaft efektiv për dialogun për politikën dhe shkëmbimin e informacionit;
SPI ka shërbyer si katalizator për rritjen e këtij angazhimi;
Që nga krijimi në 2005, SPI e përcaktoi si parim thelbësor që ndihma e huaj duhet të harmonizohet me prioritetet kombëtare;
Dialogu intensiv dhe i strukturuar mes qeverisë dhe donatorëve po e realizon këtë në terren.

Teknika: Është e dobishme që të bashkëpunohet me donatorët për të përgatitur një dokument të shkurtër që përshkruan ndërveprimin qeveri-donatorë për SPI-në si një rast "praktikash të mira" dhe të përcillet në selitë e donatorëve, me qëllim promovimin e arritjeve të SPI-së në Shqipëri duke dhënë mesazhet e sipërpërmendura.

Gjithashtu, komunikimi mund të synojë edhe organizatat ndërkombëtare që vlerësojnë performancën e Qeverisë në menaxhimin financiar dhe të politikave (p.sh. SIGMA, Banka Botërore, Komisioni Evropian), por pasi të merren masat e nevojshme për adresimin e kritikave.



Duhen mesazhe të veçanta në lidhje me agjendën e BE-së. Komisioni Evropian vlerëson çdo vit progresin e bërë në arritjen e objektivave të Integritimit Evropian. Edhe pse Komisioni nuk ka kërkesa eksplicite për sistemet planifikuese të qeverisë, kontributi i SPI-së në përmirësimin e kapaciteteve administrative do të artikulohej dhe eksplorohej më mirë me Brukselin.

Si objektiv afatmesëm i komunikimit, duhet që Shqipëria të arrijë njohje të merituar ndërkombëtare për përvetësimin e praktikave më të mira për planifikimin dhe buxhetimin. Vëmendje duhet t'u kushtohet këtyre arritjeve, pas zbatimit të raundit të përmirësimeve të procesit të SPI-së.

Gjithashtu, me dorëzimin e aplikimit për anëtarësim, dimensionin evropian bëhet edhe më i prekshëm. Është e rëndësishme që të bashkëpunohet me Delegacionin e Komisionit Evropian në Shqipëri dhe të informohet Brukseli në lidhje me efektshmërinë e SPI-së si mjet për zbatimin e agjendës së integritimit.

Delegacioni i Komisionit Evropian është përfshirë që në fillim me SPI-në. Meqë një nga qëllimet kryesore të SPI-së është që sistemet e planifikimit financiar dhe të politikave të qeverisë të çojnë përpara Integritimin Evropian, shpejt mund të vijë koha që të vlerësohet deri në çfarë mase janë arritur këto qëllime. Rezultatet duhet t'i vihen në dispozicion Komisionit në Bruksel si një model i mundshëm për vendet e tjera.

MESAZHET KYÇE PËR KOMISIONIN EVROPIAN:

SPI u krijua me parimin që sistemet kryesore të qeverisë për planifikimin financiar dhe të politikave, duhet të orientohen drejt realizimit të agjendës evropiane;
Është e pamjaftueshme që vetëm të miratohen ligje apo të krijohen struktura të reja: SPI shërben si urë ndërmjet kërkesave ligjore të integritimit evropian dhe zbatimin konkret të atyre politikave;
SPI mund të shërbejë si model për vendet e tjera aspirante për në BE.

Teknika: DEBASKON-i, MIE dhe Delegacioni i Komisionit Evropian në Shqipëri mund të shqyrtojnë mundësinë e përgatitjes së një analize të tillë për Komisionin e BE-së në Bruksel, që përmban mesazhet e sipërpërmendura, në vjeshtën e viti 2010 ose më herët, në varësi të situatës së aplikimit për anëtarësim në BE. Nga ana tjetër, MIE i raporton çdo tremujor Komisionit Evropian për programimin e IPA-s dhe PKZMSA-së. Po çfarë do të ndryshojë pas aplikimit për status kandidat? Për të rritur ndërgjegjësimin, MIE mund të miratojë një strategji të re komunikimi dhe të përgatitë fletëpalosje me informacione se çfarë pritet, "Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet candidate të BE-së", "Shqipëria aplikon për anëtarësim në BE: Cilat janë hapat e mëtejshëm?"

5.7 Pushteti vendor

- *input në strategjitë sektoriale*
- *hartim dhe zbatim i strategjive të zhvillimit rajonal*
- *rritje e rëndësisë së zhvillimit rajonal si pjesë e menaxhimit rajonal të fondeve IPA*
- *reflektimi i procesit të decentralizimit*
- *mund të përshtasë një model SPI të thjeshtuar*

Teknika: Bashkitë dinë fare pak për SPI-në. Megjithatë, arritjet e qeverisë qendrore duhet të shtrihen, të paktën pjesërisht, nëpër bashki. Në vend të një komunikimi të drejtpërdrejtë me çdo bashki, mund të mbahen diskutime me Shoqatën e Bashkive (dhe komunave) në forumin më të mirë dhe të bëhet prezantimi në një seminar njëditor. Ministria e Brendshme mund të jetë partnere në këto përpjekje.

MESAZHET KYÇE::

Që në vitin 2005, Qeveria ka zbatuar me sukses SPI-në;
SPI i ka mundësuar qeverisjes qendrore të lidhë politikën me paratë dhe paratë me rezultatet;



Edhe pse bashkitë operojnë disi ndryshe, si pushteti qendror edhe ai vendor duhet të zbatojnë këto sisteme bazë;
Disa elemente të SPI-së mund të jetë të leverdishme për pushtetin vendor;
QSH është e gatshme të japë metodologjinë dhe përvojën për çdo bashki të interesuar.

Pas çdo aktiviteti, është e rëndësishme që të merren dhe të vendosen kontaktet për bashkëpunim të mëtejshëm. Faqja e internetit e DEBASKON-it mund të shërbejë si portal apo faqe referimi për të marrë informacione apo kërkime rreth SPI-së.

5.8 Akademia dhe shoqëria civile

- *pjesëmarrës në konsultimet për SKZHI-në*
- *rritje e rolit konsultues për zhvillimin e politikave*
- *informimi më i mirë ndihmon rolin e llogaridhënies publike*

Një numër akademikësh të respektuar kanë qenë anëtarë të Grupeve Sektoriale Këshilluese që u ngritën për të orientuar zhvillimin e strategjive sektoriale. Përveç kësaj, kontaktet me komunitetin e akademikëve ka qenë minimal. Grupet Sektoriale Këshilluese shpejt do të ri-aktivizohen për të kryer monitorimin e zbatimit të strategjive.

Teknika: Ri-aktivizimi i Grupeve Sektoriale të Punës që do të zgjerohen me përfshirjen edhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile, përmbush angazhimit të SKZHI-së për përfshirjen e shoqërisë civile në monitorimin e zbatimit të strategjive sektoriale. Qëllimi është që këto dy grupe të bashkohen në një Grup Sektorial Pune të vetëm: grupi i plotë (me aktorët kryesorë) do të mbledhet 1-2 herë në vit që të monitorojë progresin dhe të evidentojë problemet e politikave. Anëtarët e Ministrisë/donatorëve mund të mbledhen më shpesh për të trajtuar çështje të ndihmës së huaj, sipas agjendës së GSP-së së tyre.

Kjo është një mundësi e mirë komunikimi për t'i përcjellë shoqërisë civile mesazhin se Qeveria është e angazhuar për një sistem më pjesëmarrës dhe po i fton të përfshihen në mënyrë të vazhdueshme. Punimet e hollësishme të SPI-së nuk do të jenë me interes për shumicën e grupeve të shoqërisë civile, por ata duhet të ndërjegjësohen se transparenca dhe konsultimi janë themeli i parimeve të SPI-së.

Përveç këtij grupi, do të ishte e dobishme që ndërjegjësimi për SPI-në të shtrihet edhe në fakultetet e universiteteve të caktuara shqiptare. Kjo mund të realizohet me anë të një vizite një herë në vit të një zyrtari të lartë qeveritar dhe të mbajë një diskutim se "Si punon qeveria", "Si vendos qeveria" dhe "Si shpenzon qeveria". Në këto diskutime, kryefjalën duhet ta ketë SPI. DEBASKON-i mund të përgatitë fletëpalosje për këto aktivitete.

5.9 Qeveritë Rajonale

- *vitet e fundit janë mbajtur mjaft evenimente rajonale të organizuara kryesisht nga Komisioni Evropian; interes është shprehur nga qeveritë rajonale për qasjen shqiptare*
- *këto kontakte rreth SPI-së mund të zgjerohen dhe të kthehen në një rrjet të gjerë shkëmbimi informacioni*

Teknika: Evenimentet si konferencat rajonale janë një mjet i mirë për promovimin e përvojës shqiptare me SPI-në. Konferencat rajonale nuk organizohen rregullisht, por kur organizohen ato paraqesin një mundësi të madhe për promovimin e çështjeve të SPI-së dhe punës së QSH-së në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në prill 2009, Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin e Komisionit Evropian dhe DEBASKON-i organizuan një takim donatorësh në Tiranë. Takimi mbledhi mbi 200 qeveri dhe zyrtarë donatorësh nga Ballkani perëndimor, Turqia dhe delegacionet e KE-së nga rajoni. Pjesëmarrësve iu vunë në dispozicion materiale të shumta informuese, sidomos ato për komponentët e SPI-së. Përfaqësuesit e DEBASKON-it treguan se SPI po ecën përpara si pjesë kyçe e planit të Shqipërisë për integrimin në BE dhe zhvillimin kombëtar.



5.10 Për Median

- është përdorur pak deri tani, por është vendimtare për një platformë komunikimi të profilit të lartë

Edhe pse media ka marrë pjesë në shumë evenimente ku janë diskutuar çështje të SPI-së (p.sh. debate ministrash në televizion për SKZHI-në), gazetatat, televizionet dhe mediat e tjera kanë shumë pak njohuri se çfarë është SPI. Kjo është e kuptueshme deri diku, pasi koncepti i SPI-së është mjaft abstrakt për publikun e gjerë dhe i drejtohet kryesisht administratës publike. Nisur nga kjo perspektivë e publikut, SPI mund të paraqitet si "markë" e një produkti që tërheq interes. Kështu, çdo platformë komunikimi mund të fokusohet në produktin specifik të ofruar për publikun (p.sh. Raportet e Progresit Vjetor të Ministrive) dhe ta përdorë SPI-në thjesht si logo apo referencë. Platforma për stilin dhe dizenjon e SPI-së mund t'i shërbejnë këtij qëllimi.

Teknika: Në TVSH (me mbulimin më të madh) po transmetohet një program për strategjitë, si edhe në kanalin dy të radios dhe televizionit të këtij stacioni publik. DEBASKON-i po luan rol kyç për të formësuar programin, duke dhënë informacion të përgjithshëm dhe kontaktet e të ftuarve potenciale nga qeveria. Programi do të transmetohet për rreth 40 javë.

Gjithashtu, do të ishte e dobishme që të synohen edhe gazetarë të tjerë radiofonikë apo televizivë që merren me çështjet e qeverisë. SPI mund të mos jetë histori shumë tërheqëse, por duke u kuptuar ajo mund të përdoret më shpesh dhe kjo do të rriste njohuritë e gazetarëve se si funksionon qeveria. Për shembull, mund të shkruhet një seksion në një apo dy gazeta, apo të përmendet në debate televizive. *Si funksionon Qeveria* mund të jetë një temë e duhur për të edukuar median dhe publikun e gjerë se si funksionon procesi i vendimmarrjes.



6. MJETET PËR ZBATIMIN E PLATFORMËS SË KOMUNIKIMIT

Me qëllim që t'i përcjellin mesazhin publikut, Platforma e Komunikimit do të shfrytëzojë mjetet, teknikat dhe aktivitetet ekzistuese dhe do të aplikojë të reja aty ku është e nevojshme.

6.1 Përdorimi dhe përditësimi i bankës së të dhënave të kontakteve të DEBASKON-it

Si pjesë e përpjekjeve për të hyrë në media dhe publik, DEBASKON-i ka mbledhur dhe grumbulluar rregullisht kontaktet e tre grupeve të mëdha publiku: media, donatorët dhe qeveria. Baza e të dhënave e masmediave kryesore të vendit u përgatit dhe u shpërnda në fund të dhjetorit 2008. Puna u përqendrua në mbledhjen e kontakteve të medias shqiptare dhe medias që huaj që operon në Shqipëri. Të dhënat iu vunë në dispozicion të gjithë stafit të DEBASKON-it. U krijuan edhe tri lista postare, me kontaktet e medias, donatorëve dhe qeverisë, me qëllim që të lehtësohej komunikimi ndërmjet DEBASKON-it dhe partnerëve. Sfida qëndron në përditësimin dhe shfrytëzimin në maksimum. Koordinatorët e DEBASKON-it do të krijojnë kontakte të reja dhe këto ndryshime duhet të pasqyrohen në bazën e të dhënave të kontakteve që zotëron DEBASKON-i. Procesi për mbledhjen e të dhënave të reja ka filluar.

6.2 Udhëzime për dizenjon e SPI-së

Udhëzimet për Dizenjoni e SPI-së është një dokument që garanton konsistencë në publikimet për SPI-në. Ato vendosin rregulla në mënyrë që të krijohet një identitet unik dhe të rritet vizibiliteti. Gjithashtu, tregojnë se si aplikohet identiteti duke përdorur logo, ngjyra, kompozime, forma karakteresh, prezantimin dhe materiale të tjera komunikimi me qëllim ruajtjen e vazhdimësisë vizive.

Janë bërë përpjekje në këtë drejtim me dizenjoni e disa publikimeve të DEBASKON-it. Letrat me logo dhe dosjet, si edhe konfigurimi i ri për kartëvizitat janë ideuar me një stil unik të zhvilluar në fillim të vitit 2009, me qëllim forcimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve me palët e treta. E gjithë kjo punë do të mblidhet dhe do të finalizohet në një dokument të vetëm.

Platforma e Dizenjosi të SPI-së. Ky do të jetë një dokument i brendshëm për t'u përdorur nga DEBASKON-i për botimet e veta që lidhen me SPI-në dhe do të garantojë konsistencën e botimeve nga ministritë. Meqë SPI nuk ka logo, do të bëhen përpjekje për ta përgatitur dhe përdorur një logo. DEBASKON-i do të vazhdojë të përdorë logon e Këshillit të Ministrave e shoqëruar me emërtimin e Departamentin. Puna për hartimin e udhëzimeve të dizenjosi do të fillojë në 2010, pas miratimit të PKSPI-ve. Puna për logon do të fillojë në fillim të 2010-ës, pasi kjo platformë komunikimi të miratohet.

6.3 Komunikatat për shtyp

DEBASKON-i do të vazhdojë të nxjerrë komunikatat për shtyp për çdo eveniment, si për tryezat e rumbullakëta Qeveri-Donatorë, konferencat, etj. Komunikatat do t'i shpërndahen medias në format elektronik dhe do të postohen në faqen e internetit (www.dsdc.gov.al). Interes të veçantë në media ka për ndihmën e huaj dhe marrëdhëniet e Qeverisë me donatorët. Përveç komunikatave për shtyp, mund të organizohen intervista me drejtuesit e DEBASKON-it në format të shtypur apo elektronik me rastin e promovimit të evenimenteve të rëndësishme.

6.4 Buletini "Dialogu Qeveri-Donatorë"

Buletini ka pësuar ndryshime të mëdha në përmbajtje dhe formatim. Përkthimi në shqip është shumë i rëndësishëm për përdoruesit shqiptarë dhe administratën publike në përgjithësi. Synimi është që buletini të kthehet në revistë të vërtetë, dhe të përmbajë jo vetëm lajme, por edhe intervista dhe profile të pjesëtarëve të Qeverisë dhe të komunitetit donator. Lista postare e



kontakteve duhet të përditësohet nga Sekretari Teknik i Donatorëve dhe personat përgjegjës në DEBASKON, me qëllim që të pasqyrohen kontaktet e reja.

6.5 Manuali i IPS-së

Manuali i ri i IPS-së që përfshin përmirësimet e reja të procesit dhe monitorimin, mund të fillohet të përgatitet nga fillimi i vitit 2010.

6.6 Kalendari i IPS-së

Kalendari rishikohet çdo vit. Përditësimi i radhës është planifikuar në fillim të vitit 2010.

6.7 Faqja e internetit e DEBASKON-it

Faqja e internetit do të vazhdojë të luajë rol të rëndësishëm në përhapjen e informacionit për procesin e SPI-së dhe ndihmën e huaj në vend. Një fushatë ndërgjegjësimi do të ndërmerret për të promovuar faqen e internetit mes institucioneve qendrore dhe donatorëve, duke shkëmbyer lidhjet përkatëse, me qëllim rritjen e trafikut dhe renditjen e kësaj faqeje. Veçori të tjera, si anketat dhe sondazhet, mund të përdoren për të mbledhur informacion, për të marrë *feedback* dhe për të ruajtur komunikimin e vazhdueshëm me lexuesit dhe publikun e gjerë. Aktualisht po zhvillohet një pyetësor për të matur ndërgjegjësimin për SPI-në. Nga statistikën e faqes mund të bëhen analiza, për shembull të evidentohen grupet e publikut që e frekuentojnë dhe njohuritë e tyre për SPI-në. Shpërndarja e buletinit elektronik mjaft abonentëve që i orienton ata të klikojnë faqen e internetit për artikuj të plotë, është një mjet i fuqishëm për të gjeneruar trafik. Mjetet e tjera, përfshi njoftimet e shpejta, mund të tërheqin vëmendjen e institucioneve homologë të DEBASKON-it duke rritur kështu përdorimin e faqes si një burim i rëndësishëm informacioni.

6.8 Sugjerim për publikime të reja

Do të ishte me vend që të përgatitet një dokument i cilësisë së lartë, tërheqës vizualisht, siç është **Arritjet e SPI-së**, ku të tregohet 'udhëtimi' pesëvjeçar që prodhoi sistemin, ndoshta më të mirë në rajon, për planifikimin financiar dhe politikat. Ky dokument do të ketë jetë të gjatë, pasi metodologjitë SPI duhet të jenë të qëndrueshme për disa vjet. Edhe pse është deri diku teknik, dokumenti duhet të paraqitet në gjuhë të qartë që të kuptohet nga komuniteti ndërkombëtar, universitetet, bashkitë, administratat rajonale dhe nëpunësit civilë. Duke ditur që interesi i medias për këto çështje është e kufizuar, duhet të krijohet mundësia që të rritet ndërgjegjësimi për llojet e produkteve që SPI ofron dhe rëndësinë e tyre.

6.9 Raporti i SPI-së

Raporti i SPI-së do të përgatitet nga CFCU-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me DEBASKON-in dhe mund të paraqitet në mbledhjet e Grupit Mbështetës të SPI-së që të informohen donatorët për progresin e secilit komponent, për shembull, Fondi Shumëpalësh i Besimit, si edhe vështirësitë e hasura dhe hapat që duhen marrë.

6.10 Krijimi i grupeve të kontaktit të SPI-së

Për të përditësuar bazën e të dhënave të DEBASKON-it, do të hartohet një listë e hollësishme e individëve që merren aktivisht me zbatimin e SPI-së, përfshi ata në ministrinë e linjës, pushtetin qendror dhe institucionet e varësisë. Ky hap do të rrisë komunikimin mes aktorëve të SPI-së. Lajmërimet, njoftimet, e-mail-a të shkurtra mund t'iu dërgohen pjesëtarëve të listës si edhe atyre të përfshirë në Dialogun Qeveri-Donatorë, bashkë me dokumente dhe publikime të tjera elektronike. Kjo listë mund të përdoret edhe për qëllime të tjera që lidhen me mesazhet e SPI-së. Gjithashtu, Eksperti i DEBASKON-it për Marrëdhëniet me Publikun mund të kontaktojë me personelin e informatikës në secilën ministri dhe institucione përkatëse për të krijuar lista të gjera (p.sh. një për institucionin) dhe më specifike.



6.11 Trajnimet për SPI-në

Ekzistojnë fare pak kurse akademike që ofrojnë trajnimin e duhur teknik për nëpunësit civilë në lidhje me praktikën e politikëbërjes, planifikimit dhe buxhetimit në qeverisje. Është e rrallë që ky trajnim të jetë efikas nëpërmjet një instituti trajnimi, edhe pse mund t'iu japë nëpunësve civilë një orientim të përgjithshëm për sistemin planifikues të qeverisë. Në fund të fundit, trajnimi më efikas jepet nga vetë institucionet qendrore. Ky trajnim nuk mund të ofrohet rregullisht, por duhet të organizohet një kurs trajnimi njëditor një apo dy herë në vit për të informuar zyrtarët ministrorë përgjegjës për koordinimin e SPI-së në ministritë e linjës në lidhje me përmirësimet e procesit. Kjo ndihmon edhe në krijimin e një rrjeti më të gjerë SPI në radhët e qeverisë.

Gjithashtu, duhet të shihet mundësia që konceptet e SPI-së të përfshihen në leksionet publike dhe private. Këtë proces mund ta nisë DEBASKON-i, të identifikojë temat dhe të ndihmojë në përgatitjen e moduleve në çdo universitet. Në varësi të interesit dhe natyrës së universitetit, materiali mund të variojë nga një orë e vetme, në një modul të tërë se *Si funksionon Qeveria*.

Përfundimisht, DEBASKON-i duhet të krijojë një rrjet më të gjerë në Rajon dhe me organizatat homologe të shteteve të reja anëtare. Vizitat studimore në Shtetet Baltike do të shërbenin për të parë sistemet e planifikimit që janë të ngjashme me ato të Shqipërisë, por disa vite më të përparuar. Nga vizitat studimore në vende të tjera evropiane (p.sh. në Skandinavi, Mbretërinë e Bashkuar, Holandë), do të mësohet se si shtetet anëtare menaxhojnë sistemet për planifikimin dhe politikën. Forumet rajonale periodike me qendra të institucioneve të tjera do të mundësojnë shkëmbimin e dijeve dhe vendosjen e objektivave të përbashkëta. Edhe pse QSH ka zhvilluar një sistem planifikimi të përshtatur sipas rrethanave specifike, shumë mund të mësohet nga përvoja e shteteve të tjera në përballimin e sfidave të njëjta.

7. PLANI I VEPRIMIT

Aktivitetet e komunikimit do të shtrihen në tri fusha: forcimi dhe shkëmbimi i ideve, i kapaciteteve dhe i trajnimeve, dhe krijimi i mekanizmave të rinj për përhapjen e informacionit, siç përshkruhet në planin e veprimit dhe tabelën përkatëse të paraqitur më poshtë.

Tabela paraqet aktivitetet dhe mekanizmat e planifikuar për të matur suksesin e Platformës së Komunikimit. Mjetet vlerësuese janë si cilësore edhe sasiore. Indikatorët cilësorë përfshijnë përgjigjet për pyetjet e hedhura në seanca informimi, në anketa, formularë vlerësimi dhe e-mail-e, si edhe nga *feedback*-u. Indikatorët sasiorë përfshijnë numrin e punonjësve që marrin pjesë në seancat e informimit, numrin e marrësve të e-mail-eve, numrin e pyetjeve, kërkesave për SPI-në, trafikun në faqen e internetit dhe rezultatet e anketave.

Që komunikimi i SPI-së të ketë sukses, është e rëndësishme të merren parasysh roli dhe përgjegjësitë e partnerëve në të gjitha veprimet e ndërmarra, përfshi komunikimin e brendshëm mes stafit. DEBASKON-i duhet të organizojë më mirë arkivin e vet, që të përballet më mirë me ndryshimin e stafit dhe të ruajë njohuritë e departamentit. Mesazhet e DEBASKON-it me grupin e kontaktit koordinimi@km.gov.al janë një mjet i mirë për të mbajtur në dijeni dhe për të përcjellë informacion e përditësuar te rangjet kryesore.

Agjencitë publicitare dhe studiot grafike janë palët e treta në dizejnim dhe prodhim. Projektet për komunikimin dhe imazhin e SPI-në, do të menaxhohen e do të koordinohen nga Specialisti i DEBASKON-it për Marrëdhëniet me Publikun nën drejtimin e Drejtorit të DEBASKON-it. Mbështetje do të jepet nga ekipi i DEBASKON-it, stafi i informatikës, Departamenti i Informimit në KM, si edhe nga të gjitha strukturat e përfshira në zbatimin e SPI-së.

Departamenti i Bashkrendimit të Strategjive dhe Kordinimit të Ndihmës së Huaj

FUSHA	PUBLIKU	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FEEDBACK / MONITORIMI	HARKU KOHOR
Forcimi dhe shkëmbimi i njohurive	Të gjitha grupet	Prodhimi dhe shpërndarja e të gjitha materialeve për SPI-në	DEBASKON, me MF, ministritë e linjës	Qarkullimi e shpërndarja e materialeve Kur njoftimi dërgohet me e-mail, verifikohet përgjigjja dhe monitorohet trafiku i shkarkimeve në faqen e internetit	Në vazhdim
		<ul style="list-style-type: none"> Raporti i Progresit 2008, SKZHI 	DEBASKON		Finalizim, publikim në dhjetor
	QSH dhe Donatorët	Raporti i Progresit, Ndihma e Huaj	DEBASKON		Finalizim, publikim në dhjetor
	QSH dhe Donatorët	<ul style="list-style-type: none"> PVH (Pani i Veprimit për Harmonizim) 	DEBASKON dhe STD		Finalizim, miratim në tryezën e rrumbullakët më 13 nëntor, 2009
	QSH dhe Donatorët	<ul style="list-style-type: none"> Kalendari 2010 SPI 	DEBASKON		Shkurt 2010
	QSH dhe Donatorët	<ul style="list-style-type: none"> Kalendari 2010 GSP 	DEBASKON dhe STD		Janar 2010
	Të gjitha grupet	<ul style="list-style-type: none"> PIM-et 2009 do të kenë për herë të parë si pjesë integrale "Raportin e Rezultateve të Ministrisë, 2008" 2010 PIM-et/Rishikimi i Politikave Prioritare 	ML dhe DEBASKON ML dhe DEBASKON		Kopje elektronike botohen në faqet e internetit të ministrive të linjës Janar 2010
	Të gjitha grupet	<ul style="list-style-type: none"> Buletini "Dialogu Qeveri-Donatorë" 	DEBASKON dhe STD		Botohet çdo muaj
	Media	Komunikatat për shtyp	DEBASKON		Për ngjarje të caktuara, në vazhdim
	QSH dhe Donatorët Media njoftohet me Komunikata Shtypi	Tryeza e rrumbullakët Qeveri-Donatorë	DEBASKON dhe STD		Nr. i pjesëmarrësve, Cilësia e debateve dhe <i>feedback</i> Mbulimi i medias, Nr. i artikujve në gazeta Vizibiliteti



FUSHA	PUBLIKU	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FEEDBACK / MONITORIMI	HARKU KOHOR
	QSH dhe Donatorët	Mbledhjet e GSP-ve	DEBASKON, STD dhe ML	Forume aktive, me fokus në çështjet teknike në zbatimin e projekteve	Caktohet në kalendarin e ri 2010 SPI që palët miratojnë
	QSH dhe Donatorët	Grupi Mbështetës i SPI-së	DEBASKON, donatorë të angazhuar me Fondin Shumëpalësh të Besimit, donatorë të tjerë	Nr. i pjesëmarrësve Cilësia e raportimit	Dy herë në vit
	Çdo donator dhe QSH	Protokoll bashkëpunimi	DEBASKON, çdo donator dhe ML	Nr. i mbledhjeve Nr. i projekt-fishave të dorëzuara	Me kërkesë të donatorit herën e parë; pastaj negociata vjetore
Forcimi i kapaciteteve dhe trajnimi	Zyrtarë të lartë të QSH	Trajnim për SP, Ministrat dhe Zv.ministrat	DEBASKON dhe Koordinatori SPI, SP i KM	Nr. i pjesëmarrësve Formularët vlerësues të trajnimit	Një trajnim u mbajt në tetor 2009, tjetri në fillim të 2010
	Nëpunësit civilë në ML	Trajnim për profesionistët e Buxhetit (GSBI)	SP i çdo ministrie me pjesëmarrjen e profesionistëve të SPI, DEBASKON mund të vëzhgojë	Nr. i pjesëmarrësve Formularët vlerësues të trajnimit	Përcaktohet në agjendën e çdo ministrie linje, në fillim të 2010
	Bashkitë	Seminar 1-ditor mbi detyra të reja të pushtetit vendor pas dorëzimit të aplikimit për status kandidat	DEBASKON, Ministria e Brendshme	Nr. i përfaqësuesve të pushtetit vendor	Mars 2010
	Administrata publike	Trajnim për nëpunësit civilë	DEBASKON, ITAP	Pyetjet në testin final do të matin sa janë kuptuar konceptet e SPI-së	Brenda kurseve të ITAP



FUSHA	PUBLIKU	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FEEDBACK / MONITORIMI	HARKU KOHOR
	DEBASKON	Vizitë studimore për ekipin e DEBASKON-it e fokusuar në futjen e komponentëve të rinj, p.sh. monitorimi i SKZHI-së, Vlerësimi i Impaktit Rregullator Komunikimi i SPI pasuron edhe më shumë ekspertizën e DEBASKON-it. Sugjerohet rinovim i pozicionit të specialistit të marrëdhënieve publike në DEBASKON nisur nga nr. i aktiviteteve dhe vëllimi i punës që rrjedh nga zbatimi i Platformës së Komunikimit. Më tej DEBASKON mund ta përfshijë këtë pozicion në strukturën permanente, pasi kjo justifikohet plotësisht nga puna intensive që bëhet për çështjet e komunikimit (konferenca, evenimente, publikime, faqe interneti, etj.)	DEBASKON DEBASKON i propozon FSHB në kontekstin e komponentit Komunikimi i SPI DEBASKON i propozon Sekretarit të Përgjithshëm të KM dhe Drejtorit të Financës dhe Burimeve Njerëzore dhe ndryshimin në strukturën e tij	Performanca e DEBASKON-it mund të matet nga rezultatet e pritshme të vizitës; mund të përdoren edhe formularë vlerësues Raporte progresi të punës së specialistit të marrëdhënieve me publikun për Drejtorin e DEBASKON-it, përgatiten rregullisht në kuadrin e raportit të komponentëve të Fondit të Besimit	Pranverë 2010 Shkurt 2010
Krijimi i mekanizmave të rinj për përhapjen e informacionit	QSH dhe Donatorët	Dokumente të brendshme: <ul style="list-style-type: none"> Platforma e Dizenjos SPI Kalendari i evenimenteve të DEBASKON 	DEBASKON	A ndjekin të gjitha botimet të njëjtat rregulla të dizenjos?	Në vazhdim Kalendari i DEBASKON-it u përgatit dhe po përdoret
	Grupi Mbështetës i SPI-së	Mjete dhe publikime të reja: <ul style="list-style-type: none"> Raportet SPI për Fondin e Besimit 			



FUSHA	PUBLIKU	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FEEDBACK / MONITORIMI	HARKU KOHOR
	Të gjitha grupet, Nëpunësit civilë, universitetet, akademia dhe shoqëria civile	<ul style="list-style-type: none">• arritjet e SPI-së• prezantime për trajnimet e ITAP dhe leksionet universitare• Fletëpalosje me mesazhe specifike për shoqërinë civile e akademinë dhe/ose për leksionet <i>Si funksion Qeveria</i>	DEBASKON		
	Të gjitha grupet	Faqja e internetit	DEBASKON	Nr. i vizitorëve në faqen e internetit	Monitorim konstant i trafikut të faqes
	Institucionet e QSH-së dhe donatorët	Grupet e kontaktit dhe e-mail-et për SPI	DEBASKON dhe LM	Nr. i pjesëtarëve në grupon e kontaktit	Frekuenca e kthimit të përgjigjeve për e-mail-et

8. BUXHETI PËR KOMUNIKIMIN E SPI-së

Komunikimi i SPI-së është komponent i rëndësishëm i Fondit Shumëpalësh të Besimit të SPI, kështu që fondet mund të gjenden brenda këtij kuadri. Duke ditur që Fondi i Besimit do të lëvrohet në vjeshtën e 2010-ës, donatorët janë të ftuar të kontribuojnë në komponentët e nevojshëm për zbatimin e Platformës së Komunikimit, me qëllim që të sigurohet zbatimi i plotë i saj. Gjithashtu, fondet për publikimin e disa dokumenteve janë parashikuar në buxhetin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e Departamentit.

Më poshtë jepet buxheti i detajuar për një vit, ndërsa jepet edhe një vlerë e përafërt për tre vitet e ardhshme për zbatimin e strategjisë. ***Vini re që këto janë kosto treguese dhe disa prej tyre kanë mbuluar tashmë periudha të caktuara.***

Aktivitetet në 2010	Vlera në Euro
Një apo dy Tryeza të Rrumbullakëta Qeveri-Donatorë (konferenca) në vit	2 * 4,000 = 8,000 Euro në vit
Seminare dhe trajnime të organizuar për DEBASKON-in (materiale, pajisje)	3 * 1,500 = 4,500 Euro
Vizita studimore për ekipin e DEBASKON-it (shkëmbim informacionin për komponentë të rinj, monitorimin e SKZHI-së, Vlerësimit e Impaktit të Politikave)	2,100 Euro për tur/3 persona, 3 net
Publikimet	
Kalendari i SPI-së, Raporti i Progresit të SKZHI-së (raporti i progresit të Ndhmës së Huaj), Arritjet e SPI-së, fletëpalosja <i>Si funksionon Qeveria</i> , broshura (sipas kërkesës), përditësim i materialeve të Marrëdhënieve me Publikun, prezantime CD-ROM	30,000 në vit
Buletini Qeveri-Donatorë do të përkthehet në shqip.	150 Euro - redaktim i anglishtes ²
Parashikohet edhe shtypja e të dy versioneve.	300 Euro - dizenoja
	200 Euro – përkthimi në shqip dhe redaktimi
	Shtypja - 500 Euro në muaj
	Totali 1,150 Euro në muaj = 13,800 Euro në vit
Materiale Promovuese	

² OSBE ka ofruar të mbështesë redaktimin e anglishtes për 2010-ën.



Mbështetje profesionale nga studio grafike dhe agjenci që merren me marrëdhëniet me publikun, për aktivitetet dhe përgatitjen e dizenjove dhe pankartave	5,000 në vit
Kartëvizita, dhurata dhe suvenire të personalizuar sipas rastit	5,000 në vit
Forcimi i kapaciteteve dhe pajisje	
Pagesa për pozicionin e Specialistit të Marrëdhënieve me Publikun	15,000 Euro në vit ³
1–2 kurse të shkurtra trajnimi mbi Komunikimin Qeveritar (mund të bëhet nëpërmjet MTEC (Matra)	Kurset ofrohen dhe sponsorizohen nga vendi pritës
Abonim në gazetatat kryesore për qëllime monitorimi	150 Euro/vit/për gazetë * 10 = 1,500 në vit
Pajisje ndihmëse:	300 Euro
• TV për të monitoruar mbulimin e medias	600 Euro
• Aparat cilësor fotografik me rezolucion të lartë, për të bërë foto të cilësisë së lartë në evenimente (10 Megapixel ose më tepër)	50 Euro
• Regjistruar Dixhitalë për intervista	
Totali i të gjitha shërbimeve në vitin e parë	85,850 Euro⁴

Platforma e Komunikimit të SPI-së do të rishikohen në fund të 2010-ës dhe mund të modifikohen për të pasqyruar situatat e reja.

Nëse keni pyetje apo sugjerime mbi Platformën e Komunikimit të SPI-së, lutem shkruani tek agerxhani@km.gov.al

³ Kostot mbulohen nga Fondi i Besimit si pjesë e komponentit të komunikimit deri në gusht 2010.

⁴ Për vitet në vazhdim mund të parashikohen kosto mesatare rreth 80 000 EUR.

